



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL
DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Tiranë, më 26.01.2021

NJOFTIM PUNËSIMI

Mbështetur në Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, (i ndryshuar), në Urdhrin e Kryeministrit nr. 143, datë 03.11.2020 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, AZHBR shpall njoftimin e punësimit si mëposhtë:

I. ASISTENT TITULLARI:

(me kontratë pune 8h/ditë), kategoria IV-b

Detyrat kryesore:

1. Kujdeset për axhendën dhe korrespondencën e Drejtorit të Përgjithshëm.
2. Informon punonjësit mbi mbledhjet e ngarkuara nga Drejtori i Përgjithshëm.
3. Ruan një linjë me protokollin për t’u informuar mbi çdo dokumentacion që vjen në Institucion.
4. Raporton tek Drejtori i Përgjithshëm mbi çdo problematikë.

Kandidatët e interesuar duhet të përmbushin këto kritere:

1. Diplomë e nivelit Bachelor, në Shkenca Shoqërore, Shkenca Ekonomike, Shkenca Juridike. *(Diplomat e marra jashtë vendit duhet të jenë të njohura paraprakisht nga institucioni përgjegjës për njehësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi).*
2. Të kenë aftësi shumë të mira komunikuese.
3. Të kenë njohuri bazë në përdorimin e kompjuterit
4. Të kenë njohuri bazë mbi zhvillimin bujqësor dhe rural në Shqipëri dhe mbi politikën e përbashkët për bujqësinë me BE-në.
5. Të kenë njohuri të gjuhës angleze.
6. Preferohet të kenë përvojë pune ose internshipi/praktika profesionale

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”.
- Ligjin nr 152/2013 “Për nëpunësin civil”,
- VKM 124 datë 17.02.2016 “Për pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”.
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9367, datë 7.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- Njohuritë mbi VKM nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë brenda datës 29.01.2021, ora 14:00 në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (Adresa: Rruga “Muhamet Gjollësja”, Nr. 56, Tiranë): Kërkesën për punësim ku duhet të përcaktojnë pozicionin për të cilin po aplikojnë; një kopje të CV të përditësuar; diplomën e noterizuar; certifikata dhe kualifikime të ndryshme; një fotokopje e librezës së punës; një kopje të ID-së; formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore të firmosur nga aplikuesi; raportin mjeko-ligjor.

TË GJITHË KANDIDATËT QË APLIKOJNË PËR POZICIONET E MËSIPËRME, DO TË MARRIN INFORMACION VETËM NË FAQEN E INTERNETIT TË AZHBR www.azhbr.gov.al, PËR FAZAT E MËTEJSHME TË KËSAJ PROCEDURE:

- për rezultatet e verifikimit
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi (testim me shkrim/ intervista me gojë)
- shpalljen e listës së fituesve

Për të marrë këto informacione, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e internetit të AZHBR www.azhbr.gov.al.

AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL